

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetar kolegji dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E.B., për shkak të veprës penale vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1638/17 të dt.24.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1305/2017 të dt.18.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 08.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit E.B., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj -Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1638/17 të dt.24.10.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1305/2017 të dt.18.01.2018 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1638/17 të dt. 24.10.2017, të dënuarin E.B., është shpallur fajtor për veprën penale vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në ndalim nga

data 12.05.2014 deri me datë 13.05.2014. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) €, kurse të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA.1nr.1305/2017 të dt.18.01.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E.B., av.S.K., nga Lipjani, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk janë vlerësuar drejt të gjitha provat dhe janë nxjerr vendime të gabuara duke e shpall fajtor të dënuarin dhe duke i shqiptuar dënimin e përcaktuar. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht ligjin penal kur të dënuarin e ka shpallur fajtor pasi që vepra penale nuk ekziston, meqë i dënuari nga viti 2006, ka iniciuar procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe çështja është vendosur në favor të të dënuarit përmes aktgjykimit C.nr.216/2006 e i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë përkatësisht Gjykata e Apelit e Kosovës e po ashtu nga Gjykata Supreme e Kosovës, e për më tepër, është bërë edhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor përmes përmbaruesit privat. Edhe pse të gjitha këto prova i ka pasur në dispozicion gjykata e shkallës së parë megjithatë ka vendosur që të dënuarin ta shpall fajtor edhe pse në rastin konkret nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale të vetëgjyqësisë dhe nuk është vërtetuar se cili veprim arbitrar është ushtruar nga i dënuari, pasi që sipas përkufizimit të veprës penale vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 i KPRK-së, është përcaktuar që i dënuari duhet të ndërmerr ndonjë veprim arbitrar

apo të ushtroj ndonjë të drejtë që mendon se i takon. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se i dënuari ka ndërmarrë ndonjë veprim arbitrar, përkundrazi veprime arbitrare i kanë ndërmarrë të dëmtuarit me ndihmën e Komunës së Shtimes dhe në dëm të të dënuarit, të cilët pa ushtruar kurrfarë procedure e shpallin këtë pjesë të parcelës rrugë me interes të përgjithshëm për shpronësim pa zbatuar kurrfarë rregulla edhe pse rruga ishte e asfaltuar paraprakisht dhe pasi që i dënuari ka filluar ta realizoj të drejtën pronësore përmes vendimit përfundimtar gjyqësor.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.42/2018 të datës 19.03.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i bazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmbajnë shkelje të ligjit penal.

Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë dhënë arsye ligjore për elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPK-së, përkatësisht kur ka konstatuar se “... duke bllokuar rrugën dhe kalueshmërinë në rrugë për të cilën rrugë kishte kontest me fqinjët e tij tani të dëmtuarit ende pa vendosur gjykata këtë kontest dhe ende pa përfunduar procedura me një vendim të plotfuqishëm...”, meqë sipas këtij aktgjykimi gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se kjo gjykatë si prova në shqyrtimin gjyqësor ka prezantuar edhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.1479/12 i datës 07.04.2015 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës REV.nr.175/15 të datës 08.10.2015 dhe konkluzionin nga përmbartuesi privat F.I.H., nr.P.nr.337/15 të datës 15.02.2017 e që bazuar

në këto prova nuk qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se aktgjykimi në këtë çështje kontestimore nuk ka marrë formën e prerë.

Po ashtu qëndron edhe pretendimi tjetër se në rastin konkret nuk është vërtetuar se cila e drejtë i ka takuar të dënuarit dhe nuk iu ka drejtuar organit kompetent për ta realizuar, meqë elementet e figurës së veprës penale të vetëgjyqësisë nga neni 418 par.1 të KPK-së realizohen në rastet kur i dënuari ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën se mendon që i takon e në rastin konkret rezulton se i dënuari ka realizuar të drejtën e tij përmes rrugës gjyqësore dhe me këtë rast është bërë përmbarimi i vendimit gjyqësor.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.61/2018, më datë 08.05.2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka